

**STATUTI I SHOQËRISË  
“OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA” SHA**

**HYRJE**

Statuti i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara”, është hartuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë”.

**TITULLI I  
EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI DHE MËNYRA FINANCIMIT**

**Neni 1  
Forma e Organizimit**

1. Shoqëria emërtohet “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
2. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është një shoqëri aksionare, që vepron në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
3. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha ka stemën, logon, dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.

**Neni 2  
Selia**

1. Selia e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është në Adresën: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është e pakufizuar.

**Neni 4  
Objekti i veprimtarisë**

1. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është kryerja e procedurave të përqendruara të prokurimit përmallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe përllogari të Kryeministrisë, Ministrive, Institucioneve në varësi të Kryeministrat e të ministrike të linjës.
2. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha si organ qendor blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve si më poshtë vijon:
  - a) blerje automjetesh;
  - b) blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet përpërdorim nga fermerët;
  - c) blerje materialesh kancelarie;
  - d) blerje orëndish dhe pajisjesh përmobilim;
  - e) blerje materialesh të ndryshme përpastrim;

- f) blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
  - g) blerje këpucësh;
  - h) blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
  - i) blerje tonerash;
  - j) shërbime në fushën e sigurimeve, si:
    - i. sigurim i automjeteve;
    - ii. sigurim i mjeteve lundruese;
    - iii. sigurim i mjeteve ajrore;
    - iv. sigurim jete dhe shëndeti;
    - v. sigurim i godinave publike;
  - k) shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;
  - l) shërbim pastrimi;
  - m) shërbim lavanderie;
  - n) shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;
  - o) riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
  - p) botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
  - q) blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;
  - r) riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;
  - s) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;
  - t) shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi;
  - u) blerje artikujsh ushqimore;
  - v) blerje pajisjesh kondicionimi;
  - w) shërbim gjelbërimi;
  - x) rikonstruksion objektesh.
3. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha me kërkesë të një apo të disa autoriteteve/enteve kontraktore, zhvillon procedura prokurimi edhe për punë/mallra/shërbime, të cilat nuk janë listuar në pikën 2, të këtij Statuti, në rastet kur autoriteti/enti kontraktor kërkues nuk ka kapacitete apo njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi. Mënyra, afatet dhe krieteret e vlerësimit të kërkesvae parashikohen në rregulloren e brendshme të shoqërisë Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
4. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.
5. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimit, për të nënshkruar marrëveshjen kuadër dhe kryerjen e procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.
6. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha krijon regjistrin e parashikimeve për procedurat e prokurimit që zhvillohen prej tyre menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga marrja e kërkesave për prokurim nga autoritetet/entet kontraktore.
7. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha për nevojat e saj mund të nënshkruajë:
- a) marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - b) marrëveshje bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e ndihmës/ekspertizës së nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit, nëpërputhje me kuadrin ligjor në fuqi apo rritjen e kapaciteteve institucionale;

- c) marrëveshje bashkëpunimi me ekspertë të fushave të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 5 Mënyra e financimit**

1. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha financohet nga të ardhurat e veta, të ardhura nga shërbimet ndaj të tretëve, të konsulencës, nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme.
2. Përqindja e tarifës për shërbimin e kryer ndaj autoriteteve kontraktore do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 6 Procedurat e prokurimit**

1. Procedurat e prokurimit nga ana e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha do të kryhen konform Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.
2. Mënyra e organizimit dhe komunikimit institucional mes shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha dhe Institucioneve rregullohet sipas parashikimit të legjislacionit të prokurimit publik si dhe rregullores së funksionimit të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
3. Autoritetet/entet kontraktore duhet t’i dërgojnë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha si organ qendor blerës, të dhënë teknike e sasiore dhe të dhëna për fondin përkatës përmallrat e shërbimet bazuar ne rregulloren e brendshme te funksionimit te shoqerise dhe akteve ligjore dhe nen ligjore në fuqi.

## **TITULLI II KAPITALI DHE AKSIONET**

### **Neni 7 Kapitali**

1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është 20,000,000 (njëzet milion lekë) lekë dhe është i ndarë në 20,000 (njëzet mijë) aksione me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secili.
2. Në çastin e themelimit, kapitali është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, si më poshtë vijon:
  - a) shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria që përfaqëson ekonominë, ka kontribuar në para në kapitalin e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, me një shumë të barabartë prej 20,000,000 (njëzet milion lekë) lekësh.
3. Në çastin e themelimit, bazuar në kontributet e sipërpërmendura, shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë, zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.

### **Neni 8 Aksionet**

1. Aksionet e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha janë të zakonshme dhe regjistrohen në regjistrin e aksioneve. Shoqëria mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
2. Një akt emetimi aksionesh hartohet në momentin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban informacionet e kërkua nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 9 Transferimi i aksioneve**

1. Transferimi i aksioneve tek të tretët i nënshtrohet miratimit të aksionarit që ka shumicën e aksioneve si dhe ndryshimi në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha kryhen në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarët”. Transferimi dhe procedurat e transferimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 10 Ndryshimi i kapitalit**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë apo zvogëlojë kapitalin e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha në zbatim të këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Kontributet e reja për zmadhimin e kapitalit mund të konsistonë në para ose pasuri dhe të drejta të vlerësueshme në para.

## **TITULLI III ORGANET E SHOQËRISË OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SHA DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 11 Organet e OBP**

1. Organet drejtuese të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme
  - b) Këshilli Mbikëqyrës
  - c) Drejtori

### **Neni 12 Asambleja e Përgjithshme**

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ministri përgjegjës për ekonominë, në cilësinë e aksionarit të vetëm.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare;
  - b. ndryshime të statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e Drejtorit;
  - d. emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës
  - e. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- f. miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d";
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- j. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- k. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

### **Neni 13**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Drejtori dhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e saj.
3. Në njoftim jepen:
  - a) emërtimi dhe selia e shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha dhe lloji i mbledhjes;
  - b) rendi i ditës, vendi, data dhe koha e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme;
  - c) programi dhe procedurat.
4. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë kryesore të shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, ose në ndonjë vend tjetër të caktuar nga aksionari(ët). Asambleja e Përgjithshme mund të mbajë mbledhjet edhe nëpërmjet telekonferencës apo mjeteve të ngashme të komunikimit.
5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave të pranishëm në vende të ndryshme, të lidhur nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, në përputhje me metodat e zakonshme të telekomunikimit, ku përfshihen mjetet elektronike, me kusht që të gjithë aksionarët, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës ose video konferencës apo mjeteve të ngashme elektronike, të identifikohen dhe atyre t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë drejtpërdrejt në çështjet e trajtuarra dhe për të marrë, dërguar ose shqyrtuar dokumentet.

### **Neni 14**

#### **Kuorumi**

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**Neni 15**  
**Rendi i ditës në Asamblenë e Përgjithshme**

1. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje për të cilën Asambleja e Përgjithshme merr një vendim.
2. Asambleja e Përgjithshme nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
3. Aksionarët kanë të drejtë të përfaqësohen nga një person tjetër, në bazë të një prokure/autorizimi me shkrim. Në çdo rast, prokura/autorizimi jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të marrin pjesë edhe anëtarët e organeve të tjera drejtuese, Administratori dhe zyrtarë të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
5. Administratori dhe anëtarët e organeve drejtuese nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme.

**Neni 16**  
**Protokolli**

1. Asambleja e Përgjithshme cakton një Sekretar për mbajtjen e procesverbaleve.
2. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme regjistrohet në procesverbal. Sekretari eshtë përgjegjës për mbajtjen dhe ruajtjen e procesverbaleve.
3. Në procesverbal shënohen të dhënat në vijim:
  - vendi dhe data e mbledhjes;
  - rendi i ditës;
  - vendimet e marra.
4. Procesverbalit i bashkëngjiten lista e pjesëmarrësve, si dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
5. Prosesverbali dhe lista e pjesëmarrësve nënshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
6. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Sekretari eshtë i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes në faqen e internetit të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
7. Organet drejtuese dhe zyrtarët e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha ngarkohen me zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 17**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet deri në gjashtë anëtar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, ku një prej tyre përfaqëson ministritë përgjegjëse për financat.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë me shumicë votash njërin prej tyre si kryetar, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë.

- Kriteret pér zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen konform Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.570/2018.
- Shpërblimi pér anëtarët dhe kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës bëhet konform Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.570/2018.

**Neni 18**  
**Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen në detyrë pér një afat jo më të gjatë se tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- Nëse një anëtar nuk është në gjendje të përbushë detyrat e tij, ose mungon në më shumë se tre mbledhje, atëherë Asambleja e Përgjithshme liron/shkarkon këtë anëtar dhe emëron një anëtar të ri.
- Një ose më shumë anëtar mund të lirohen/shkarkohen, nga Asambleja e Përgjithshme. Rastet e lirimit/shkarkimit përfshijnë rotacionin, neglizhencën në kryerjen e detyrave, shkeljen e rendë të rregullave të brendshme dhe cënimin e interesit të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, dënimin nga gjykata me vendim të formës së prerë pér kryerjen e një vepre ose kundravajte penale, falimentimin, ndalimin ose pezullimin nga gjykata pér ushtrimin e detyrës si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshterinë, marrjen pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike gjatë kryerjes së detyrës.
- Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës mund të japë dorëheqjen, në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Asamblenë e Përgjithshme. Dorëheqja hyn në fuqi në kohën e përcaktuar në të.

**Neni 19**  
**Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës**

- Këshilli Mbikëqyrës siguron që shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha gëzon autonomi operacionale në veprimtarinë e saj, dhe ka këto kompetenca:
  - propozon Asamblesë së Përgjithshme Statutin e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha dhe ndryshimet në të;
  - propozon Asamblesë së Përgjithshme politikat tregtare të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha;
  - miraton programet e zhvillimit ekonomik të shoqërisë;
  - miraton ngritjen e strukturave të tjera të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha;
  - shqyrtion dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standarde kontabilitetit;
  - siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo Statutit, kryhen me saktësi nga shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha;
  - krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, dhe pér çështje të tjera;
  - miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
  - Miraton rregullat pér mënyrën, rastet dhe shpërbimin e pajtimit të këshilltarëve të jashtëm ose ndihmët të jashtëm pér procedurat e prokurimit.
- Personat e mëposhtëm emërohen si anëtar të parë të Këshillit Mbikëqyrës:

- a) Znj. Lira Pipa
- b) Z. Sokol Ismaili
- c) Znj. Alketa Pernaska
- d) Znj. Elinda Pupla
- e) Z. Edmond Ahmeti
- f) Z. Sokol Bardhi

**Neni 20**  
**Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në selinë e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha ose në një vend tjetër, sipas kërkesës së drejtuesit të mbledhjes ose të shumicës së anëtarëve.
2. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet rregullisht të paktën 6 herë në vit, si dhe sa herë që e kërkon interesë i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
3. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet në një seancë të veçantë me kërkesë të kryetarit apo dy prej anëtarëve të tij, ose me iniciativën e Drejtorit.
4. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të marrë pjesë në një takim personalisht, Këshilli Mbikëqyrës do të lehtësojë lidhjet me mjete të tjera të mundshme, përfshirë telekonferencën apo mjete të ngjashme të komunikimit.
5. Kuorumi për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës arrihet nëse tre nga gjashtë anëtarët e tij janë të pranishëm.
6. Një shumicë e anëtarëve të pranishëm, pavarësisht nëse është pjesë e një kuorumi, mund të shtyjnë mbledhjen në një kohë dhe vend tjetër, duke njoftuar të gjithë anëtarët.
7. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës apo me mjete të ngjashme te komunikimit, me kusht që anëtarët e tjerë të kenë mundësi të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara. Në këtë rast, mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet drejtuesi i mbledhjes.

**Neni 21**  
**Vendimmarrja**

1. Këshilli Mbikëqyrës synon të marrë vendime bazuar në konsensus. Në rast kur nuk mund të arrihet konsensus, Këshilli merr vendimet me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare.
3. Punonjësit e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha ngarkohen me zbatimin e vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës.

**Neni 22**  
**Procesverbale e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron një sekretar, i cili është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:
  - a) të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës;

- b) të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe pjesëmarrësve të tjerë në çdo mbledhje.

### **Neni 23** **Drejtori**

1. Drejtori i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha emërohet dhe lirohet nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Drejtori emërohet në detyrë, për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet.
3. Drejtori i raporton Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullisht.
4. Drejtor emërohet personi që:
  - a) të jetë shtetas shqiptar;
  - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - d) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;
  - e) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion, prej të cilave 3 (tre) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;
  - f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.
5. Lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit bëhet sipas përcaktimeve të pikave 8 dhe 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, datë 07.09.2023.
6. Paga e Drejtorit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
7. Drejtor i parë caktohet Znj. Arlinda Pogaj, shtetas shqiptar, lindur në Qelëz Pukë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034054048, banues në adresën: Bulevardi Migjeni, Rr. Aleksandri i Madh, Pall. Everest, Hyrja nr.1, Ap.19, Njësia Administrative 14.

### **Neni 24** **Kompetencat e Drejtorit**

1. Drejtori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
2. Drejtori kryen administrimin e zakonshëm të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, brenda kufive të vendosur nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statuti dhe aktet e brendshme, dhe kompetencat e deleguara shprehimisht nga Këshilli Mbikëqyrës.
3. Drejtori mund të marrë pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
4. Drejtori ka të drejtë dhe detyrohet:
  - a) të administrojë veprimtarinë e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha në marrëdhënie me të tretët;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël;
  - d) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
  - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rr Ethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën;

- f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi;
  - g) të raportojë përpara organeve drejtuese për zbatimin e politikave, planeve të punës, dhe projekteve të investimit;
  - h) të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblessë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit dhe akteve të brendshme të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha;
  - i) të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të organeve drejtuese të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha.
5. Drejtori mund të marrë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.

## **TITULLI IV DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 25 Viti finanziar dhe ndarja e dividendëve**

1. Viti finanziar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, shpërndahen, si më poshtë vijon:
  - a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit te nënshkruar;
  - b) pjesa e mbetur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ri investohet në shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha ose në fonde të tjera rezervë, sipas parashikimve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendos që fitimet të ri investohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali, në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me politikën për dividendët.

### **Neni 26 Kontabiliteti**

1. Shoqëria “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtori dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, sipas ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

### **Neni 27 Audituesit ligjorë**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë auditues ligjor të jashtëm e të pavavarur, të cilët kanë fituar këtë titull sipas ligjit.

2. Audituesit ligjor kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Asambleja e Përgjithshme emëron si auditues të parë ligjor:
  - a) Ilda Duhanxhiu,
  - b) Klodiana Ngjeçi.

**Neni 28**  
**Prishja, ndarja dhe bashkimi**

1. Shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha mund të prishet, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
2. Me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme vendos për ndarjen, bashkimin, ose prishjen e shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha. Prishja Ndarja dhe bashkimi bëhet nga Asambleja e Përgjithshme pas miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 29**  
**Legjislacioni i zbatueshëm**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dheshoqëritë tregtare", ligjit "Për prokurimin publik", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 30**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

**Neni 31**  
**Dispozita përfundimtare**

1. Çështjet, të cilat nuk parashikohen shprehimisht nga ky Statut, rregullohen nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.531, datë 07.09.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë", Rregulloren e funksionimit ose në akte të tjera të brendshme të shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha.

Tiranë më, 28.02.2024

